

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zelensky 'sinjalizon' paqen: Jemi gati për kompromis
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zelensky-sinjalizon-paqen-jemi-gati-per-kompromis-i584916
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 09:49:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 10:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d48231feca18a12856a019f231d42d26bf0f9e668b5cd73a66351504360d3b8
TEKSTI	120a568e29bab034b774648394287904254942063b40755a74414778d5e45909
PAMJA	9fc086ec222a023fed70fe45038487af31ff71560b14a00dd3a37bc8a9e1dc53

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	38b02ee431a0b637734e49f85c9eb7b54a89617cfe65abf4ef7070b6bbcc89ad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/38b02ee431a0b637734e49f85c9eb7b54a89617cfe65abf4ef7070b6bbcc89ad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Një i vdekur dhe tre të plagosur pasi ranë në kontakt me rrymen. Policia ndalon zyrtaret e Bashkisë TirojeKosovë/ Albulena Haxhiu zgjidhet kryetare e KuvenditLuka Modric mbush sot 41 vjeç fundit](#)

Zelensky ‘sinjalizon’ paqen: Jemi gati për kompromis

9 Shtator 2026, 12:35Bota TEMA



Zelensky ‘sinjalizon’ paqen: Jemi gati për kompromis

Volodymyr Zelensky rikthen në vëmendje nevojën për forcimin e mbrojtjes ukrainase, ndërsa në planin diplomatik po merr formë hipoteza e një procesi negociues trepalësh. Në një intervistë telefonike me një grup mediash ndërkombëtare, ku mori pjesë edhe “La Stampa”, presidenti ukrainas trajtoi çështjet kryesore të luftës.

Nga marrëdhëniet me Uashingtonin te një samit i mundshëm trepalësh me Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara, roli i Europës dhe kërcënimi për një mobilizim të ri rus.

Mesazhi i Zelenskyt është i qartë: “Kievi është i gatshëm për kompromis, por nuk ka ndërmend të jetë pala e vetme që bën lëshime. Nuk mund të jetë gjithmonë Ukraina ajo që lëshon: ne kemi bërë tashmë shumë compromise”, theksoi ai.

Një nga temat e para të trajtuara ishte Mykhailo Fedorov, ish-ministër i Mbrojtjes i Ukrainës, i cili aktualisht përmendet si këshilltar i ministrit italian Guido Crosetto për inovacionin dhe teknologjitë ushtarake.

Përgjigjja e Zelenskyt tregon njëfarë ftohtësie: “Të them të drejtën, nuk e shoh dhe nuk kam komunikuar me të prej shumë kohësh”, deklaroi presidenti.

Ai shtoi se nuk kishte informacion të saktë për vendndodhjen e tij: “Më thonë se ndodhet jashtë vendit. Nuk kam detaje: as telefonatë, as mesazh”.

Thelbi i intervistës lidhet me kontaktet diplomatike mes Uashingtonit, Kievit dhe Moskës. Zelensky u njohu të dërguarve amerikanë Steve Witkoff dhe Jared Kushner një rol të rëndësishëm në rifillimin e negociatave.

“Para së gjithash, dua të falënderoj palën amerikane për ndihmën në zhblokimin e negociatave mes ukrainasve dhe rusëve”, tha ai.

Sipas presidentit ukrainas, misionet e tyre patën edhe një rëndësi politike, pasi të dërguarit e Donald Trump vizituan si Moskën, ashtu edhe Kievin, duke treguar, sipas Zelenskyt, një qasje të ekuilibruar: “Është e rëndësishme që ata kanë qenë në të dyja kryeqytetet”.

Megjithatë, lufta vazhdon të rëndojë veçanërisht në frontin e mbrojtjes ajrore. “Na duhen raketa”, tha Zelensky. Çështja e furnizimit me sisteme për mbrojtjen e qiellit ukrainas nga raketat dhe dronët e Kremlinit është në qendër të marrëdhënieve me Shtëpinë e Bardhë.

Në këtë kuadër përfshihet edhe programi Frejja, për të cilin Zelensky shpreson të sigurojë mbështetjen e Uashingtonit. Çështja pritet të ngrihet edhe në takimin e ardhshëm me Trump, të cilin presidenti ukrainas shpreson ta zhvillojë rreth datës 20 shtator. “Shpresojmë të kemi një rezultat”, tha ai, duke folur për mundësinë e zhblokimit të dërgesave të sistemeve Patriot.

Në planin diplomatik, Zelensky konfirmoi se po punohet për një format trepalësh mes Ukrainës, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara, detajet e të cilit, megjithatë, mbeten konfidenciale. “Kemi rënë dakord me amerikanët që fillimisht të punojmë brenda këtij formati dhe më pas të komunikojmë publikisht”, shpjegoi ai.

Sipas presidentit ukrainas, tashmë në tryezë ndodhen “disa ide të vlefshme dhe interesante” për arritjen e një marrëveshjeje paqeje. Megjithatë, asnjë prej këtyre propozimeve nuk konsiderohet ende përfundimtar.

“Nuk e dimë ende nëse mund të zbatohen, nëse do të funksionojnë dhe nëse do të prodhojnë rezultate”, saktësoi Zelensky.

Duke iu rikthyer misionit të Witkoff dhe Kushner, ai tha: “Dua që të kthehen”, duke nënvizuar se edhe vendimi i të dërguarve amerikanë për të udhëtuar drejt Kievit me tren duhet parë në kuadër të situatës delikate të sigurisë.

Ukraina, tregoi ai, ishte e gatshme të priste një avion amerikan në aeroportet e Boryspilit ose Zhulianit, por Rusia goditi pistat e uljes dhe ngritjes për të “përhapur idenë se bëhet fjalë për një vend jo të sigurt”.

Një tjetër kapitull lidhet me marrëveshjet e mundshme ekonomike mes Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë. Zelensky pranoi se nuk i njeh të gjitha detajet e bisedimeve, por mendon se energjia është një nga sektorët kryesorë. Qëndrimi i Kievit, megjithatë, mbetet i prerë: “Ukraina duhet ta pengojë Rusinë të sigurojë burime të tjera për financimin e luftës”.

Veçanërisht shqetësuese, sipas vlerësimit të Kievit, është edhe hipoteza e një mobilizimi të ri rus, e mohuar me forcë nga presidenti rus dhe e cilësuar prej tij si “një absurditet total”. Zelensky, përkundrazi, pretendon se Moska mund të rekrutojë të paktën 300 mijë persona të rinj pas zgjedhjeve për Dumën: “Ne jemi të sigurt se kjo do të ndodhë pas zgjedhjeve”.

Në këtë situatë, roli i Europës bëhet vendimtar për Kievin. Zelensky nuk e konsideron Brukselin thjesht një mbështetës financiar apo ushtarak të Ukrainës. “Është thelbësore”, tha ai duke folur për pjesëmarrjen europiane në negociatë, duke sqaruar: “Europa duhet të jetë në tryezë”.

Arsyeja lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e kontinentit: “Po flasim për të ardhmen e gjithë Europës”.

Mbajtja e europianëve në tryezën e negociatave, gjë që rusët dhe amerikanët duan ta shmangin, i shërben Kievit edhe në pritje të zhblokimit të furnizimeve ushtarake nga SHBA. Paralelisht, qeveria ukrainase po punon me partnerët europianë për të ashtuquajturën paketë dimërore.

Në këtë pikë, Zelensky falënderoi Britaninë e Madhe për fondin prej 100 milionë paundësh të njoftuar një ditë më parë, i cili do të përdoret veçanërisht për mbrojtjen ajrore.

Objekti i deklaruar mbetet kalimi në një fazë të re të negociatave gjatë vjeshtës. Zelensky dëshiron të takohet me Trump në shtator dhe të përgatisë me shpejtësi samitin e ardhshëm trepalësh. “Sa më shpejt, aq më mirë”, tha ai.

Por, deri në arritjen e marrëveshjeve konkrete, Kievi po përgatitet për një dimër lufte. Për këtë arsye, Ukraina e konsideron të domosdoshme vazhdimin e marrjes së ndihmës ushtarake, në mënyrë që të jetë më e fortë në terren dhe, rrjedhimisht, edhe në planin diplomatik.

Kështu, ndërsa kërkohen formula të reja për të arritur paqen, mesazhi i Zelenskyt për aleatët perëndimorë mbetet i qartë: “Deri atëherë, paketat amerikane të armatimeve për mbrojtjen kundër raketave do të jenë jetike”.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Telefonata njëorëshe Trump-Putin, Kremli: Bisedë konstruktive, Rusia nuk ka plane agresive ndaj Europës](#)

09:35 Bota / 1 koment

[Rubio paralajmëron Iranin: Sa herë të tentoni të godisni anijet amerikane, do të humbni cisterna](#)

09:25 Bota / 1 koment

[SHBA godet cisternat iraniane të naftës; Irani bazat amerikane në Jordani](#)

09:05 Bota

[Kaos në aeroportet britanike, mbi 600 fluturime anulohen pas defektit në sistemin e kontrollit ajror](#)

08:15 Bota / 2 komente

[SHBA ndalon një sërë produktesh kanadeze](#)

08:05 Bota

[Trump distancohet nga Netanyahu për Bregun Perëndimor, SHBA nuk pengon sanksionet ndaj vendbanimeve izraelite në zonën e pushtuar](#)

07:53 Bota

[Gjermania do të dërgojë urgjentisht raketa interceptuese “Patriot” në Ukrainë: Duhet mburojë ajrore kundër sulmeve ruse](#)

07:46 Bota / 1 koment

[Po mbulonin ngjarjen e vullkanit në Indonezi, zhduken 5 gazetarë](#)

23:00 Bota

[Itali/ 157 kg kokainë të fshehura në kamionin me kuaj, droga vlente deri në 14 milionë euro! Shpërndahej edhe nga trafikantët shqiptarë](#)

22:40 Bota

[Gjykata amerikane: Kushtetuta federale nuk garanton të drejtën për ujë të pastër](#)

22:20 Bota / 3 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 51 komente

[Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ç...](#)

10:10 Sociale / 26 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 106 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 109 komente

Blog Tema

[Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat](#)

25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001

09:15 Blog /2 komente

“Respekte”, z. Korrupsion!

22:30 Blog /9 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by [Tomorrow.io](#)

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by